

DFE - Ferronikeli

Vendi:	Rajonal
Numri i Projektit:	50978
Spektori i Biznesit:	Burime Natyrore
Lloji i Njoftimit	Privat
Kategoria Mjedisore:	B
Data e synuar e Bordit:	25 Qershor 2019
Statusi:	E aprovuar nga Bordi
PSD e shpalosur:	29 Korrik 2019

Përshkrimi i Projektit:

Ofrimi i nje huaje prej 25 milionë euro per Ferronikeli Complex LLC ("Kompania" ose "NFN"), për të mbështetur 15 milionë euro shpenzime kapitale për efizienzë në energji dhe 10 milionë euro financim i kapitalit të punës për rritjen efizienzës operationale dhe përmirësimin standardeve mjedisore (uljen e nivelit të CO₂, SO₂, NOX dhe emetimin e grimacve).

Objektivat e Projektit:

Synimi i projektit eshte të mbështesë një përmirësim te performancës së NFN, eksportuesi më i madh dhe një nga punëdhënësit më të mëdhenj privatë në Kosovë, duke ulur kostot dhe rritur konkurrueshmërinë e NFNs dhe performancën mjedisore nëpërmjet investimeve në efizienzën e energjisë.

Ndikimi ne Tranzicion:

Ndikimi në tranzicion i projektit vjen si rezultat i cilësive te mëposhtme:

Cilësia parësore - E gjelbër: projekti do të mbështesë perpjekjet per sfidat mjedisore nëpërmjet investimeve që do të sjellin përmirësime në efizienzën e energjisë, uljen e emetimeve të grimcave dhe gazrave me efekt serë (GHG), dhe standardeve mjedisore më të larta në pajisjet për procesimin e nikelit. 47% e financimit të BERZH do të përdoret për investime në mbështetje të Tranzicionit në Ekonominë e Gjelbër (GET).

Cilësia dytësore - Konkurrueshmëria: Projekti paraqet qasje të reja operationale që do të përmirësojnë në mënyrë domethënëse efizienzën e operationeve të klientit. NFN shfaqet si lider në sektorin e minierave në rajon duke implementuar një set masash për modernizimin e kompanisë dhe paraqet një rast suksesesi se si nje kompani minierash mund te përmirësoje dukshem performancën e saj.

Informacion për Klientin: FERRONIKEL COMPLEX LLC

E themeluar në 1989 dhe e privatizuar në 2006, NFN është një kompani prodhimi e ferronikelit me qendër në Drenas, Kosovë. Ajo prodhon nikel të një cilësie të lartë me qëllim të vetëm eksportin me rreth 7000 t/vit në kapacitet të plotë. NFN është eksportuesi më i madh në Kosovë, zë rreth 40% e eksporteve vjetore të vendit dhe është nga punëdhënësit më te mëdhenj privatë.

Në Gusht te vitit 2018, Balfin, grupi i kompanive më i madh në Shqipëri, bleu 90% të aksioneve të Kompanisë nëpërmjet entitetit Britanik NKL Ltd., ndersa pjesa tjetër e aksioneve zotërohet nga Clearglass Investment Limited (Cyprus).

Permbledhja e Financimit te BERZH: 25,000,000 euro**Kostoja Totale e Projektit: 25,000,000 euro****Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale:**

Projekti është kategorizuar B në përputhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale te BERZH. Analiza mjedisore dhe sociale u bë nëpërmjet një vizite në terren të dy minierave në Kosovë dhe impjantit të shkrirjes dhe rishikimi i paketës me informacion e mundësuar nga Klienti. Impakti mjedisor dhe social si rrjedhoje e implementimit te Programit Capex të Efiçencës Energjitike është identifikuar tashmë dhe do të menaxhohet nëpërmjet Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social (PVMS), për tu finalizuar para firmosjes së kredisë. Rreziqet kryesore mjedisore dhe sociale kane te bejne kryeshisht me shëndetin dhe sigurinë (për punëtorët dhe komunitetin) për shkak të emetimit të pluhurit dhe përdoruesit e paligjshëm të tokës ku ndodhet fabrika e NFN.

NFN ka një skuadër dhe një strukturë të gatshme për të siguruar përputhjen me rregullat kombetare. NFN ka çertifikimin ISO9001 dhe ISO14001 për procesimin e nikelit (vetëm shkrirja). NFN parashikon një klauzolë specifike në kontrata ku u kërkohet kontraktorëve, nënkontraktorëve dhe furnitorëve kryesorë të respektojnë pikat C138 dhe 182 të Konventës së ILOs . Ka një sindikatë punëtorësh në funksion. Sipas kushteve të PVMS, një mekanizëm ankese do të zhvillohet për ankesat e punetoreve. Për sa i përket emetimeve në ajër, njësitë kryesore janë të pajisura me një sistem që zvogëlon emetimin (precipitator elektrostatik pas furrës rrotulluese dhe gërryrës pas shkrirësit dhe furrës) të cilat përputhen me lejen e NFN IPPC; sidoqoftë një studim kundrejt teknikave më të mira në dispozicion (Best Available Techniques) është një nga kërkesat e PVMS për të kontrolluar përputhshmërinë me standardet Europiane.

Emetimi aktual i CO2 parashikohet të jetë rreth 750 kt/në vit. Projekti pritet të ulë emetimet deri në 5% për GHG, 40% për SOx, 35% për NOx dhe 50% për pluhurin dhe të rrisë efiçencën në energji me 15%. 100% e masës ujore industriale riciklohet pas përdorimit. Mbetja kryesore gjenerohet nga skorjet nga furra elektrike (300,000 ton në vit), e cila shkarkohet në gropat e minierës. Analizat kimike me përmbajtjen e skorjes dhe analizat e kullimit të bëra nga laboratorët e jashtëm në vitin 2008 nxorrën si përfundim se skorjet janë inerte. PVMS kërkon një analizë të përditësuar dhe eksplorimin e mundësisë së riciklimit. Kontrollat mjekësore bëhen çdo vit për punëtorët e NFN. Një Vlersim i Ekspozimit të Higjenës Industriale (për punëtorët) kërkohet nga PVMS, sikurse dhe Vleresimi i Riskut Shëndetësor për të vlersuar ndikimin mbi shëndetin e komunitetit lokal nga emetimet e NFN. PVMS kërkon rekrutimin e një Oficeri Ndërlidhës Komunitar dhe vendosjen e një mekanizmi për ankese nga komuniteti. Prona e parrethuar e NFN me shtrirje me sipërfaqe rreth 22 hektarë në jug të fabrikes aktualisht është e banuar në mënyrë të paligjshme nga 20 familje dhe biznese lokale; BERZH do të mundësojë mbështetje

nëpërmjet konsulencës për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje. NFN ka rënë dakord të publikojë përmbledhjet vjetore të rezultateve të performancës mjedisore në faqen e tyre elektronike.

Banka do të monitorojë implementimin e PVMS nëpërmjet përmbledhjeve të Raporteve Vjetore Mjedisore dhe Sociale (RVMS) dhe komunikimet me Kompaninë sipas nevojave.

Bashkëpunimi Teknik:

Projekti parashikon një komponent bashkëpunimi teknik, i cili perbehet nga 100,000 euro për analizen teknike dhe të tregut, dhe 23,000 euro për një vlersim të pavarur të komponentit GET të projektit. Për më tepër, BERZH po merr parasysh mundësimin e një granti prej 20,000 euro për mbështetjen e zhvillimit të një sistemi menaxhimi Siguri&Shendet të akredituar (standard ISO45001) dhe një granti prej 20,000 për një audit privat për shëndetin dhe sigurinë në punë.

Informacion mbi Kontaktin e Kompanisë

Mr. Steven Grunerud

s.grunerud@balfin.al

+355 4 2389252

Rruga Besim Mala nr.227, 13000 Glllogoc, Republika e Kosoves

Mundësitë për biznes

Për mundësitë e biznesit ose prokurimit, kontaktoni kompaninë e klientit.

Per projektet e sektorit publik, [vizitoni prokurimin e BERZH](#): Tel: +442073386794

Email: procurement@ebrd.com

Informacione të përgjithshme

Informacione rreth projekteve të BERZH-it që nuk lidhen me prokurimet

Tel: +44 20 7338 7168;

Email: projectenquiries@ebrd.com

Politika e Informimit Publik (PIP)

PIP-ja përcakton mënyrën se si BERZH-i e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe perceptimin më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të saj. Ju lutem vizitoni faqen e Faqen e Politikës se Informacionit Publik për të mësuar se si të kërkonte një raport të Bordit të Sektorit Publik.

[Teksti i PIP-së](#)

Mekanizmi i Ankesave të Projektit (MAP)

[Mekanizmi i Ankesave të Projektit](#) (MAP) mundëson shqyrtimin e pavarur të ankesave të individëve dhe organizatave lidhur me projektet e financuara nga BERZH-i, të cilat hamendësohet të kenë shkaktuar, apo të kenë gjasa të shkaktojnë, dëme mjedisore dhe / ose sociale.

Ju lutemi [vizitoni faqen e Mekanizmit të Ankesave të Projektit](#) për të gjetur informacione se si të paraqisni një ankesë. Zyrtari i PCM (pcm@ebrd.com) është në dispozicion për t'iu përgjigjur pyetjeve që mund të keni lidhur me paraqitjen e një ankese dhe kriteret për regjistrim dhe pranueshmëri, në përputhje me Rregulloren e Procedurës së PCM.